



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 3.7.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Lutfi Zharku, Andin Hoti, Danush Ademi, Ganimete Musliu, Salih Salihu, Salih Zyba, Enver Hoti.

Munguan: Besa Gaxherri, Srdjan Mitrovic, Liburn Aliu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Editë Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, **Daut Haradinaj**, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 26.6.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 qershor 2018

Kryetari i komisionit konstatoi se miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26 qershor 2018 do ta bëjë në mbledhjen e radhës për shkak se ende nuk është e gatshme me përkthim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Kryetari Daut Haradinaj, informoi anëtarët e Komisionit se Grupi punues për Projektligjin për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, e ka shqyrtuar dhe ka përgatitë amendamentet për këtë projektligj të cilin ka kryesuar **zj. Ganimete Musliu**. Ajo informoi Komisionin se Grupi i punës ka mbajtur 2 mbledhje dhe është shqyrtuar projektligji nen për nen si dhe komentet e Qeverisë. Në Grup punues kanë marrë pjesë, Idriz Blakaj nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale; Suzana Goranci nga Ministria e Mjedisit; Vjollca Aliu nga Ministria e Kulturës dhe Musa Dragusha nga Oda e Avokatëve të Kosovës. Grupi i punës ka përgatitë 22 amendamente të cilat janë të gatshme për votim, ndërsa ka pasë dilema në dy nene (4 dhe 7), për të cilat u ftua drejtori i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale Z. **Idriz Blakaj**, për

të dhënë disa sqarime shtesë. Ai për skjarim për paragrafin 1 të nenit 4, paraqiti hartën e zonës së Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz dhe sipërfaqen prej 450 ha, e cila është përgatitë në bazë të planit ideor për Kompleksin Memorial të punuar nga grupi i ekspertëve i kryesuar nga prof. Bashkim Fehmiu. Për këtë nen diskutuan dhe kërkuan skjarime shtesë në lidhje me këtë plan edhe deputetët: **Salih Zyba, Lutfi Zharku** dhe **Enver Hoti**. Ndërsa për paragrafin 1 të nenit 7, u tha se është një riformulim më i mirë dhe u pajtuan të gjithë.

Në fund Komisioni i votoi në mënyrë unanime Raportin me 22 amendamente dhe e dërgoi në Komisionet e përhershme :

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit: “**Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, “Kompleksi Memorial” dhe ”kompleksi”**”: zëvendësohen me: “**Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz”**”

Amendamenti 2

Neni 2, nënparagrafi 1.1, riformulohet si në vijim:

1.1. Zona e veçantë me interes shtetëror dhe kombëtar - Sipërfaqja e përcaktuar si zonë e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, për qëllim të këtij ligji.

Amendamenti 3

Neni 2, nënparagrafi 1.3, riformulohet si në vijim:

1.3. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz- Hapësira e zonës së veçantë me interes shtetëror dhe kombëtar, ashtu siç është e definuar me dispozitat e këtij Ligji;

Amendamenti 4

Neni 2, nënparagrafi 1.9, pas fjalës “**rastin**” të shtohet edhe “**shënimit të**” dhe vazhdon teksti ashtu siç është në projektligj.

Amendamenti 5

Titulli i kapitullit II, dhe titulli i nenit 3, riformulohen si në vijim:

**“SHPALLJA E KOMPLEKSIT MEMORIAL “ADEM JASHARI” NË PREKAZ
ZONË E VEÇANTË ME INTERES SHTETËROR DHE KOMBËTAR”**

Amendamenti 6

Neni 3, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Duke patur parasysh rolin dhe rëndësinë e veçantë të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), kontributin e Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe të familjes së tij për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në fshatin Prekaz, Komuna e Skenderajt, shpallet “Zonë e veçantë me interes shtetëror dhe kombëtar”.

Amendamenti 7

Neni 4, paragrafi 1, pas numrit në kllapa “**(450 ha)**”, pjesa në vazhdim riformulohet si në vijim: **sipas planit ideor për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz” të hartuar nga grupi punues i ekspertëve, e në përputhje me sipërfaqen e përcaktuar me ligjet në fuqi.**

Amendamenti 8

Neni 5, paragrafi 2 ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

2. Përzgjedhja e projektit për implementimin konform këtij ligji, e bën Komiteti Ndërministror i cili themelohet me vendim të Qeverisë.

Amendamenti 9

Neni 5, paragrafi 3 riformulohet si në vijim:

3. Komiteti nga paragrafi 2 i këtij neni përbëhet nga: Zyra e Kryeministrit kryesues i Komitetit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit,, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Muzeu i Kosovës, Instituti i Historisë, Instituti Albanologjik, Komuna e Skenderajt, Përfaqësuesi i Familjes Jashari, Përfaqësuesi i Shoqatës së Arkitektëve dhe Përfaqësuesi i OVL të UÇK-së.

Amendamenti 10

Neni 5, paragrafi 4, fjala “Këshilli” të zëvendësohet me fjalën “Komiteti Ndërmnistror”.

Amendamenti 11

Neni 5, paragrafi 5 zëvendësohet me tekstin si në vijim:

5.Me propozimin e Komitetit Ndërmnistror, Qeveria vendos për: kriteret, kushtet shpalljen e konkursit si dhe procedurat e aplikimit të përzgjedhjes së projektit. Pas miratimit të tyre nga Qeveria, Komiteti Ndërmnistror obligohet për zbatimin e tyre.

Amendamenti 12

Neni 5, paragrafi 6 fshihet.

Amendamenti 13

Neni 5, paragrafi 7, pas fjalëve “si dhe afatet kohore për finalizimin e saj” shtohen fjalët “në pajtim me kriteret, kushtet shpalljen e konkursit si dhe procedurat e aplikimit të përzgjedhjes së projektit të propozuara nga Komiteti Ndërmnistror dhe të miratuara nga Qeveria”.

Amendamenti 14

Neni 5, pas paragrafit 7 shtohet paragraf i ri me tekstin si në vijim:

“Komiteti Ndërmnistror i themeluar në pajtim me këtë nen, do të përfundojë mandatin e tij me përfundimin e implementimit të projektit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” ai do ti dorëzohet Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në pajtim me mandatin e tij ligjor”.

Amendamenti 15

Neni 6, paragrafi 1 fjala “Këshilli” zëvendësohet me fjalën “Komiteti Ndërmnistror” dhe pas fjalëve “nga ana e operatorit të përzgjedhur” shtohen fjalët “në pajtim me kriteret, kushtet shpalljen e konkursit si dhe procedurat e aplikimit të përzgjedhjes së projektit të propozuara nga Komiteti Ndërmnistror dhe të miratuara nga Qeveria”.

Amendamenti 16

Neni 7, paragrafi 1, pjesa e fjalisë “që paraqesin pengesë për realizimin e projektit të Kompleksit.” zëvendësohet me “nevojiten për realizimin e këtij projekti.”

Neni 7, paragrafi 3, fjala “ligjeve” zëvendësohet me “legjislacionit”

Amendamenti 17

Neni 9, paragrafi 4, fshihet.

Amendamenti 18

Neni 10, paragrafi 1 fshihet.

Amendamenti 19

Neni 10, paragrafi 2 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

2. Me propozim të Agjencisë për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, Qeveria miraton aktin nënligjor për rregullat dhe mënyrën e sjelljes së vizitorëve në hapësirat e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” në Prekaz.

Amendamenti 20

Neni 14, paragrafi 1, riformulohet si në vijim:

1. Mjetet e nevojshme për zbatimin e këtij ligji do të ndahen nga buxheti i Republikës së Kosovës dhe donacionet e ndryshme.

Amendamenti 21

Neni 14, paragrafi 3, fshihet.

Amendamenti 22

Neni 15, ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

“Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, propozohen nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe miratohen nga Qeveria në afat prej tre (3) muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

4. Të ndryshme

Kryetari Daut Haradinaj njoftoi anëtarët e komisionit për dëmet e shkaktuara nga reshjet në Kosovë, raport ky i marrë nga Ministria e Bujqësisë në formë elektronike një ditë më parë. Duke marrë parasysh këto dëme që ishin në vlerë të konsiderushme Kryetari pa të arsyshme që mledhja e komisionit të mbahet më 10 korrik 2018 ku do të ftohet Ministri i Bujqësisë për raportim.

Mbledhja përfundoi në orën 11,45.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj